



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI
Sesioni pranveror

Kryesia e Kuvendit

P-017

Prishtinë, më 5 shkurt 2018, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 5 SHKURT 2018

Në mbledhje morën pjesë: Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit; Aida Dërguti, Kujtim Shala, Xhavit Haliti, Slavko Simiq dhe Mufera Shinik, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare: Glauk Konjufca, Avdullah Hoti, Memli Krasniqi, Teuta Haxhiu, Sasha Milosavljeviq, Bilall Sherifi dhe Albert Kinolli.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Blerand Stavileci dhe Avni Bytyqi.

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Xheladin Hoxha, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj, Musli Krasniqi dhe Osman Shatri.

Nga EUSR-ja: Blerta Bejtullahu,

Nga OSBE-ja: Sanije Berisha,

Nga NDI-ja: Shefki Kastrati.

Mbledhjen e kryesoi Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit.

Kryetari e hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës.

Ai propozoi që rendit të ditës t'i shtohen edhe tri (3) pika shtesë, të cilat i miratoi Kryesia e Kuvendit.

Kryesia, me propozimin e kryetarit, i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

1. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mëparshme,
2. Përgatitjet për seancën plenare të radhës dhe
3. Shqyrtimi i propozimeve dhe kërkesave.

1. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mëparshme e Kryesisë së Kuvendit

Kryesia i miratoi pa vërejtje procesverbalet e mbledhjeve të Kryesisë, të mbajtura më 22 dhe 30 janar 2018.

2. Përgatitjet për seancën plenare të radhës

Kryetari propozoi që për dy interpelancat për kryeministrin, sipas kërkesave të grupeve parlamentare të LDK-së dhe LVV-së të mbahet vetëm një, pasi të dyja kanë të bëjnë me të njëjtën çështje.

Lidhur me propozimin e lartcekur të kryetarit të Kuvendit, Kadri Veseli, diskutuan Kujtim Shala dhe Xhavit Haliti, nënkryetarë të Kuvendit, si dhe Avdullah Hoti, në emër të GP të LDK-së; Glauk Konjufca, në emër të GP të LVV-së; Bilall Sherifi, në emër të GP të "Nisma për Kosovën", dhe Teuta Haxhiu, në emër të GP të AAK-së, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, me propozim të nënkryetarit të Kuvendit, z. Kujtim Shala, dhe me pëlqim të kryetarit të GP të LVV-së, z. Glauk Konjufca, Kryesia e Kuvendit vendosi që në seancën plenare të radhës të zhvillohet vetëm një interpelancë për Kryeministrin, sipas kërkesës së GP të LDK-së dhe GP të LVV-së.

Më pas, kryetari i njoftoi të pranishmit me pikat e rendit të ditës që i plotësojnë kushtet për shqyrtim në seancë plenare.

Në vazhdim, kryetari propozoi që edhe pika 6 - Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes për Kufirin Shtetëror ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi të hiqet nga rendi i ditës i seancës plenare të radhës.

Lidhur me propozimin e kryetarit diskutoi nënkryetari i Kuvendit, z. Kujtim Shala, diskutimi i të cilit është dhënë i plotë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, Kryesia me shumicë votash (4 “për”, 1 “kundër” (Kujtim Shala) dhe 1 “abstenim” (Aida Dërguti), vendosi që pika 6 - Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes për Kufirin Shtetëror ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi të hiqet nga rendi i ditës i seancës plenare të radhës, për ta shqyrtuar në njërën nga seancat e radhës.

Pastaj, Kryesia e Kuvendit vendosi që, seanca plenare e Kuvendit të mbahet të enjten, më 8 shkurt 2018, në orën 10:00, me këtë:

Rend dite

- 1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,*
- 2. Koha për pyetje parlamentare,*
- 3. Miratimi i procesverbalit nga seanca e mëparshme,*
- 4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-219 për të huajt,*
- 5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për mbrojtje nga rrezatimi dhe siguri bërthamore,*
- 6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për pajisjet nën presion,*
- 7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Shërbimin Gjeologjik të Kosovës,*
- 8. Debat parlamentar, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje” lidhur me dënimin e disa aktivistëve të këtij subjekti politik,*
- 9. Interpelanca e kryeministrit të Republikës së Kosovës, z. Ramush Haradinaj, sipas kërkesës së GP të Lidhjes Demokratike të Kosovës dhe GP të Lëvizjes “Vetëvendosjes” lidhur me Vendimin e Qeverisë së Kosovës nr. 04/20, datë 20. 12. 2017 për rritjen e pagave të anëtarëve të Kabinetit qeveritar, Vendimin nr. 05/24, datë 12. 1. 2018, për rritjen e pagave për të gjitha kategoritë e të punësuarve që marrin pagë nga Buxheti i Kosovës, si dhe Vendimin nr. 15/24, datë 12. 1. 2018 për lartësinë e pagesës mujore për familjet në Skemën e Ndhimave Sociale,*
- 10. Debat parlamentar, sipas kërkesës së nënkryetarit të Kuvendit, z. Kujtim Shala dhe gjashtë (6) deputetëve nënshkrues lidhur me raportin e 100 ditëve të punës të Qeverisë së Republikës të Kosovës,*
- 11. Shqyrtimi i rekomandimeve të Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione në lidhje me faturimin e energjisë elektrike të shpenzuar në katër komunat veriore të Republikës së Kosovës,*
- 12. Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sport, Inovacion dhe Ndërmarrësi për ratifikimin e nëntë (9) anëtarëve të Këshillit Shtetëror të Cilësisë,*
- 13. Shqyrtimi i raportit vjetor të performansës së Zyrës Kombëtare të Auditimit për vitin 2016,*
- 14. Shqyrtimi i raportit për gjendjen e mjedisit në Kosovë për vitin 2016.*

3. Shqyrtimi i propozimeve dhe kërkesave

1. Nisma legislative “Projektligji për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 05/L-029 për tatimin në të ardhurat e korporatave”, hartuar nga GP i Lidhjes Demokratike të Kosovës

Kryesia, pasi e shqyrtoi nismën e lartshënuar, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Kërkohet nga Qeveria e Republikës së Kosovës që të paraqesë mendim lidhur me nismën legislative “Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-029 për tatimin në të ardhurat e korporatave”, si dhe ta përgatisë Deklaratën e ndikimit buxhetor dhe Deklaratën për përafrim me legjislacionin e BE-së të këtij projektligji në afat prej një (1) muaji nga dita e pranimit.

2. Nisma legislative “Projektligji për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 05/L-037 për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar”, hartuar nga GP i Lidhjes Demokratike të Kosovës

Kryesia, pasi e shqyrtoi nismën e lartshënuar, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Kërkohet nga Qeveria e Republikës së Kosovës që të paraqesë mendim lidhur me nismën legislative “Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. nr. 05/L-037 për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar”, si dhe të përgatisë Deklaratën e ndikimit buxhetor dhe Deklaratën për përafrim me legjislacionin e BE-së të këtij projektligji në afat prej një (1) muaji nga dita e pranimit.

3. Nisma legislative “Projektligji për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 05/L-028 për tatimin në të ardhurat personale”, hartuar nga GP i Lidhjes Demokratike të Kosovës

Kryesia, pasi e shqyrtoi nismën e lartshënuar, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Kërkohet nga Qeveria e Republikës së Kosovës, që të paraqet mendim lidhur me nismën legislative “Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-028 për tatimin në të ardhurat personale”, si dhe të përgatisë Deklaratën e ndikimit buxhetor dhe Deklaratën për përafrim me legjislacionin e BE-së të këtij projektligji në afat prej një (1) muaji nga dita e pranimit.

4. Propozim-vendimi për caktimin e këshilltareve në grupet parlamentare

Kryesia, pasi e shqyrtoi propozim-vendimin e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

Për lejimin e stafit mbështetës politik profesional për Grupin Parlamentar

1. E drejta për staf mbështetës politik profesional i takon Grupit Parlamentar, si në vijim:

1.1 Grupi Parlamentar deri në 10 deputetë, një (1) këshilltar politik profesional,

1.2 Grupi Parlamentar me 11-20 deputetë, dy (2) këshilltarë politikë profesionalë,

1.3 Grupi Parlamentar me 21-30 deputetë, tre (3) këshilltarë politikë profesionalë dhe

1.4 Grupi Parlamentar mbi 30 deputetë, katër (4) këshilltarë politikë profesionalë.

5. Kërkesa e nënkryetarit të Kuvendit, z. Kujtim Shala, dhe pesë (5) deputetëve nënshkrues për debat parlamentar lidhur me takimin IV të përbashkët të Komisionit Parlamentar të Marrëveshjes për Stabilizim-Asociim, BE-Kosovë, të mbajtur më 17-19 janar 2018, në Strasburg (Francë)

Kryesia vendosi që kërkesa e lartcekur të radhitet në rend të ditës për seancën tjetër plenare të radhës.

6. Propozimi i deputetit Zenun Pajaziti, kryesues i Forumit për Transparencë Parlamentare, për organizimin e ditëve të Kuvendit gjatë vitit 2018

Kryesia, pasi e shqyrtoi propozimin e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

Lejohet organizimi i Ditëve të Kuvendit gjatë vitit 2018, për mbajtjen e takimeve publike me qytetarët në 11 komuna të Kosovës, sipas kalendarit të bashkangjitur.

7. Kërkesa e Komisionit për Buxhet dhe Financa për lejimin e vizitës zyrtare në Vjenë (Austri)

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

1. Deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës: Lumir Abdixhiku, Mërgim Lushtaku, Blerim Kuçi dhe Dardan Sejdiu u lejohet pjesëmarrja në Seminarin “Politikat mikroekonomike të FMN-së dhe ndërtimi i kapaciteteve”, që do të mbahet në Vjenë (Austri), prej 25-28 shkurt 2018.

2. Shpenzimet e akomodimit, ushqimit e transportit lokal mbulohen nga organizatori, ndërsa mëditjet për të lartshënuarit në pikën një (1) të këtij vendimi mbulohen nga Buxheti i Kuvendit të Kosovës, si dhe shpenzimet e biletave të udhëtimit fillimisht do të mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Kosovës dhe pas përfundimit të realizimit të udhëtimit, shuma prej 300 euro për person, për shpenzimet e biletave do të mbulohet nga organizatori.

8. Kërkesa e deputetes Hykmete Bajrami për lejimin e udhëtimit zyrtar në Stamboll (Turqi)

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

1. Deputetes së Kuvendit të Republikës së Kosovës, Hykmete Bajrami, i lejohej pjesëmarrja në “Kongresi Botëror i Investitorëve Engjëj 2018”, që do të mbahet në Stamboll (Turqi), prej 18-20 shkurt 2018.

2. Shpenzimet e udhëtimit, akomodimit (në bazë të rezervimeve paraprake) dhe mëditjet për të lartshënuarën në pikën një (1) të këtij vendimi mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

9. Njoftimi i Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal lidhur me udhëtimin zyrtar të realizuar në Vjenë (Austri)

Kryesia u njoftua me shkrim nga Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal lidhur me udhëtimin zyrtar të realizuar në Vjenë (Austri), nga 18-20 dhjetor 2017.

10. Informata e Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit lidhur me realizimin e punëtorisë, të realizuar në Tiranë (Shqipëri)

Kryesia u njoftua me shkrim nga Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit lidhur me vizitën zyrtare të realizuar në Tiranë (Shqipëri), nga 26-28 dhjetor 2017.

Pikat shtesë:

1. Propozimi i Komisionit për Punë të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike për formimin e grupeve të Miqësisë të Legjislaturës VI

Kryesia, pasi e shqyrtoi propozimin e Komisionit për Punë të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike për formimin e grupeve të miqësisë ndërmjet Kuvendit të Republikës së Kosovës me kuvendet e shteteve tjera, mori këtë:

V E N D I M

I. Formohen 46 grupe të miqësisë për Legjislaturën VI ndërmjet Kuvendit të Republikës së Kosovës me kuvendet e shteteve, si në vijim:

1. Grupi i Miqësisë me Austrinë,
2. Grupi i Miqësisë me Arabinë Saudite,
3. Grupi i Miqësisë me Belgjikën,
4. Grupi i Miqësisë me Mbretërinë e Bashkuar,
5. Grupi i Miqësisë me Bullgarinë,
6. Grupi i Miqësisë me Francën,
7. Grupi i Miqësisë me Danimarkën,
8. Grupi i Miqësisë me Emiratet e Bashkuara Arabe,
9. Grupi i Miqësisë me Estoninë,
10. Grupi i Miqësisë me Egjiptin,
11. Grupi i Miqësisë me Finlandën,
12. Grupi i Miqësisë me Holandën,
13. Grupi i Miqësisë me Hungarinë,
14. Grupi i Miqësisë me Irlandën,
15. Grupi i Miqësisë me Japoninë,
16. Grupi i Miqësisë me Turqinë,
17. Grupi i Miqësisë me Ganën,
18. Grupi i Miqësisë me Gjermaninë,
19. Grupi i Miqësisë me Greqinë,
20. Grupi i Miqësisë me Italinë,
21. Grupi i Miqësisë me Kanadanë,
22. Grupi i Miqësisë me Katarin,
23. Grupi i Miqësisë me Kroacinë,
24. Grupi i Miqësisë me Kuvajtin,
25. Grupi i Miqësisë me Letoninë,
26. Grupi i Miqësisë me Lituaninë,
27. Grupi i Miqësisë me Luksemburgun,
28. Grupi i Miqësisë me Maltën,

29. Grupi i Miqësisë me Maqedoninë,
30. Grupi i Miqësisë me Malin e Zi,
31. Grupi i Miqësisë me Malajzinë,
32. Grupi i Miqësisë me Panamanë,
33. Grupi i Miqësisë me Poloninë,
34. Grupi i Miqësisë me Portugalinë,
35. Grupi i Miqësisë me Qipron,
36. Grupi i Miqësisë me Rumaninë,
37. Grupi i Miqësisë me Spanjën,
38. Grupi i Miqësisë me Suedinë,
39. Grupi i Miqësisë me Sllovakinë,
40. Grupi i Miqësisë me Slloveninë,
41. Grupi i Miqësisë me Shqipërinë,
42. Grupi i Miqësisë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës,
43. Grupi i Miqësisë me Tunizinë,
44. Grupi i Miqësisë me Vatikanin,
45. Grupi i Miqësisë me Zvicrën dhe
46. Grupi i Miqësisë me Australinë, Zelandën e Re dhe shtetet tjera të Oqeanisë.

II. Grupet e miqësisë sipas pikës (I) të këtij vendimi, për secilin shtet veç e veç, përbëhen sipas listës së propozuar nga Komisioni për Punë të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike .

III. Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit.

2. Kërkesa e Komisionit për Integritim Evropian për lejimin e udhëtimit në Shkup (Maqedoni)

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

1. Deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës: Blerta Deliu-Kodra, Armend Zemaj dhe Fikrim Damka u lejohet pjesëmarrja në Konferencën XIII të komisioneve parlamentare për integritim evropian të shteteve pjesëmarrëse në Procesin e Stabilizim-Asociim të Evropës Juglindore, që do të mbahet në Shkup (Maqedoni), prej 25-27 shkurt 2018.
2. Shpenzimet akomodimit mbulohen nga organizatori, ndërsa transporti dhe shpenzimet e udhëtimit si dhe mëditjet për të lartshënuarit në pikën një (1) të këtij vendimi mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

3. Kërkesa e OJQ-së "Toka" për pagesën e qirasë, sipas Memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet Kuvendit, Fondacionit ERSTE dhe OJQ-së "Toka"

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet kërkesa e OJQ-së "Toka" për pagesën e qirasë për periudhën janar-qershor të vitit 2018, në shumën prej 5 275 (pesëmijë e dyqind e shtatëdhjetë e pesë) euro.
2. Shuma e mjeteve të lejuara në pikën një (1) të këtij vendimi ndahen nga kategoria subvencione dhe transfere.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë së Kuvendit në orën 11:45 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Kadri Veseli

Procesverbalin e hartoi:

Drejtoria për Çështje Plenare dhe Procedurale